

# DITARI MUJOR **NENTOR 2024**

## FESTAT E 28-29 NËNTORIT

Në kuadër të festave kombëtare të 28-29 Nëntorit, Instituti i Kulturës dhe Trashëgimisë Kombëtare vizitoi një sërë banesash me status monument kulture në qytete të ndryshme të Shqipërisë.

Qëllimi i këtyre vizitave ishte krijimi i mini-dokumentarëve të dedikuar për secilën banesë, duke theksuar rëndësinë e tyre historike dhe arkitektonike.

Këto projekte synojnë të ndërgjegjësojnë publikun mbi vlerat e pasura të trashëgimisë sonë kombëtare dhe të nxisin ruajtjen e tyre për brezat e ardhshëm.



# MUZEU ETNOGRAFIK, KRUJË



## Një derë e hapur drejt traditës dhe historisë

Muzeu Etnografik në Kalanë e Krujës është më shumë se një ndërtesë historike; është një pasqyrë e gjallë e jetës dhe traditave të shqiptarëve ndër shekuj. I ndodhur në një banesë karakteristike të shtresës feudale të pasur të shekullit XIX, ky muze ruan në detaje artin, kulturën dhe zakonet e përjetësuara me përkushtim brez pas brezi.

Në kuadër të festave të 28-29 Nëntorit, ftojmë të gjithë të përjetojnë këtë udhëtim në rrënjët e trashëgimisë sonë kulturore.



# KULLA E NGUJIMIT, THETH

## Një dëshmi e traditës në Alpet Shqiptare

Kulla e Ngujimit në Theth qëndron si një simbol i së drejtës zakonore shqiptare dhe Kanunit të Lekë Dukagjinit. E ndërtuar në shekullin XIX, kjo kullë unike ka shërbyer si strehë për ata që kërkonin mbrojtje gjatë konflikteve familjare. Muret e trasha prej guri dhe ambientet e saj funksionale janë një dëshmi e mënyrës se si traditat shqiptare përballonin drejtësinë në kohërat e vështira. Në kuadër të festave të 28-29 Nëntorit, udhëtoni në historinë e një monumenti që përfaqëson shpirtin dhe qëndresën e shqiptarëve.



# BANESA OSO KUKA, SHKODËR



## Një udhëtim në historinë e Shkodrës

Banesës së Oso Kukës i kemi kushtuar një vëmendje të veçantë në kuadër të festave të 28-29 Nëntorit. Ky monument kulture mbart në vetvete kujtimet e një kohe të lavdishme, duke qëndruar si simbol i rezistencës dhe identitetit kombëtar.


Zbuloni trashëgiminë e saj unike dhe rëndësinë që mbart për historinë shqiptare.



# BANESA PASHKO VASA, SHKODËR

## Hapësira që rrëfen historinë e kombit

Banesës së Pashko Vasës, këtij monumenti me vlera të jashtëzakonshme historike e kulturore, i kushtuam një vështrim të veçantë në kuadër të festave të 28-29 Nëntorit. Ky objekt, i ndërtuar në një truall të gjerë dhe i lidhur me historinë e figurës së shquar kombëtare, qëndron si një dëshmi e gjallë e trashëgimisë sonë. Bashkohuni me ne për të zbuluar historinë dhe arkitekturën e kësaj pasurie të paçmueshme të kombit.



# BANESA ÇAC DOLLANI, BERAT


## Një shembull i shkëlqyer i arkitekturës beratase

Banesa Çac Dollani në Berat, një monument i kategorisë së parë që daton rreth vitit 1870, përfaqëson më së miri arkitekturën tradicionale të lagjes Kala. Me strukturë të ndërtuar prej guri dhe elemente të spikatura si erkerët dhe dritaret karakteristike, kjo banesë ruan vlerat historike dhe estetike të qytetit të një mbi një dritareve.

Në kuadër të festave të 28-29 Nëntorit, ndalemi për të ndriçuar historinë e kësaj pasurie të trashëgimisë sonë kombëtare.





# BANESA E SKËNDULATËVE, GJIROKASTËR



## Një dëshmi e pasurisë arkitektonike dhe shpirtit të tregtisë në Gjirokastrë

Banesa e Skëndulatëve, një nga thesaret e qytetit të gurtë, daton në shekullin XVIII dhe reflekton mjeshtërinë e arkitekturës tradicionale shqiptare. Me dhoma të dekoruara me ornamente të pasura, hajat të bollshëm, dhe hapësira funksionale, kjo banesë ka qenë një simbol i begatisë dhe kulturës tregtare të familjeve të njohura në Gjirokastrë.

Në prag të festave të 28-29 Nëntorit, përjetoni historinë dhe traditat shqiptare përmes një monumenti që mishëron elegancën dhe qëndresën e kohërave.



# BANESA VANGJUSH MIO, KORÇË

## Një monument përjetësues i një artisti të madh

Banesa e Vangjush Mios në Korçë, një ndërtesë tipike e arkitekturës qytetare korçare, është më shumë se një shtëpi – ajo është një dëshmi e trashëgimisë së pasur kulturore dhe artistike të qytetit. Si vendbanimi dhe studioja e parë e piktorit të shquar shqiptar, kjo banesë bart në çdo cep të saj shpirtin krijues të një figure ikonike të artit shqiptar.

Në prag të festave të 28-29 Nëntorit, i kushtojmë një moment këtij thesari të historisë dhe artit të kombit tonë.



# QENDRA HISTORIKE, QEPARO



## Një thesar historik mes detit dhe maleve

Qendra Historike e Qeparoit, një perlë e trashëgimisë kulturore shqiptare, ruan gjurmët e arkitekturës tradicionale dhe historisë së lashtë të bregdetit të Himarës. E vendosur mes kodrave dhe detit, fshati Qeparo është i njohur për rrugicat e ngushta me kalldrëm, shtëpitë karakteristike prej guri dhe muret mbrojtëse që kanë sfiduar shekujt. Qendra historike përfaqëson një ndërthurje të rrallë të natyrës dhe kulturës shqiptare, duke dëshmuar mënyrën e jetesës së brezave të shkuar.

Në kuadër të festave të 28-29 Nëntorit, rikujtojmë vlerat e një destinacioni që frymëzon krenarinë kombëtare dhe kujton rrënjët tona.



# MUZEU ARKEOLOGJIK, KORÇË

## Fillojnë punimet për rikonstruksionin e Muzeut Arkeologjik të Korçës.

Specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore zhvilluan një inspektim të detajuar sot në Muzeun Arkeologjik të Korçës, me fokus në monitorimin dhe mbikëqyrjen e punimeve që po realizohen në kuadër të projektit të restaurimit.



Në kuadër të projektit për restaurimin e muzeut, do kryhen ndërhyrjet si më poshtë:

- Ndërhyrje përforcuese në themelet e ndërtesës dhe në muraturë;
- Restaurim i çatisë në tërësinë e elementeve të saj konstruktivë;
- Restaurim i muraturës prej guri;
- Restaurim i ndërkatëve;
- Restaurim i elementëve drusorë në interior.

iktk.gov.al



# INSPEKTIME NË TERREN

Specialistë nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) realizuan një inspektim në terren në qytetin e Gjirokastrës për të dokumentuar gjendjen ekzistuese të **Banesës së Bashkim Ahmetit**, Monument Kulture i kategorisë së dytë.

Ky inspektim synoi vlerësimin e nevojave të ruajtjes së monumentit dhe grumbullimin e të dhënave të domosdoshme për hartimin e një projekti të plotë restaurimi.



# PARKU ARKEOLOGJIK I APOLONISË

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, nis puna për projektin **“Landscaping and Entry to Apollonia Archeological Park”**. Ky projekt synon të transformojë përvojën e vizitorëve dhe të ruajë vlerat e këtij monumenti të rëndësishëm historik.

Ndërhyrjet kryesore përfshijnë:

- Riorganizimin e parkimit dhe orientimin e hyrjeve.
- Ndërtimin e një strukture moderne shërbimi me biletari, infopoint dhe transport ekologjik.
- Rindërtimin e shtigjeve për akses më të lehtë në pikat arkeologjike.
- Përmirësimin e sinjalistikës dhe shtimin e elementeve të mobilimit urban.

Parku Arkeologjik i Apolonisë, shpallur monument kulture që prej vitit 1948, është një nga atraksionet më të mëdha arkeologjike në Ballkan. Ky projekt premtan ta bëjë këtë destinacion edhe më tërheqës për vizitorët nga e gjithë bota.




# KULLA E KURPALËVE, HAS

## Kulla e Kurpalëve - Një trashëgimi kulturore që rilind

Inaugurimi i Shtëpisë Muze të Kurpalëve, një pasuri e rrallë e trashëgimisë sonë kulturore, e cila tashmë merr jetë falë programit #BonusiRijetësimit - për restaurimin dhe rijetësimin e monumenteve historike.

Kjo kullë e lashtë, me vlera të jashtëzakonshme arkitektonike dhe historike, është rikthyer në shkëlqimin e saj origjinal për të na kujtuar historinë, traditat dhe identitetin tonë kombëtar.

Inaugurimi i saj, simbolizon frymën e unitetit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore, duke e bërë këtë monument një hapësirë të hapur për vizitorë, studiues dhe artdashës.



# PROJEKTE RESTAURIMI

## Ndërhyrja më e madhe në trashëgiminë kulturore të Gjirokastrës brenda një viti!

Në qarkun e Gjirokastrës po realizohen një sërë projektesh restaurimi me rëndësi të veçantë për ruajtjen dhe promovimin e pasurisë sonë kulturore.

Projekte aktualisht në proces në Monumente Kulture të Kategorisë I-rë:

- Restaurimi i Urës së Mesit pjesë e Tri Urave të vogla mbi përroin e Zerzebililit
- Ndërhyrje emergjente për “Urën mbi Përroin e Benjës”
- Restaurimi i Urave të Kollorcës, Glinës dhe Haskovës
- Restaurimi i murit perëndimor në “Banesën Fico”

Projekte që pritet të nisin:

- Restaurimi i “Kishës së Manastirit të Shën Mëri Spilesë”
- “Banesa e Angonatëve”
- “Sarajet e Myfit Beut”, në Libohovë
- Kisha e Manastirit të Shpërfytyrimit, në fshatin Çatistë

Në bashkëpunim me CHWB, janë duke u restauruar kishat përgjatë Luginës së Drinos:

- Manastiri i Shën Qirjakut dhe Julitës në Dhuvjan
- Manastiri i Ungjëllizimit në fshatin Vanistër

Në bashkinë Përmet është duke përfunduar restaurimi i:

- Kishës së “Shën e Premtes”



**PROJEKTE RESTAURIMI**

**Ura e Kollorcës** është Monument Kulture kategoria I-rë, dt. 06.01.1977. Ndodhet mbi lumën Drino, rreth 4 km në jug-lindje të Gjirokastrës. Ura përshkon nga pesë harka të mëdhenj dhe arrihet në gjatësi totale 103 m. Në kuadër të projektit të restaurimit të urës, do të kryhen ndërhyrjet si më poshtë:

- Restaurim i çarjeve në mur gur me teknika e injektimit;
- Ndërtim muri me gur të gëlqeror me lac;
- Restaurim muri gur parasel;
- F.V. hekur betoni;
- Pastrim nga bimësia e ujit.

iktk.gov.al



**PROJEKTE RESTAURIMI**

**Ura e Zerzebililit** është monument i trashëgimisë kulturore në rrethin e Gjirokastrës. Në kuadër të projektit të restaurimit të urës janë planifikuar ndërhyrjet si më poshtë:

- Ndërtimura konsoliduese dhe restauruese në 15 qitë të muraturës formuese të urës;
- Pastrim i krusit të urës dhe mureve të sipërlutave, në 18 ditë fevradit;
- Heqje e strukturave prej betoni që shpërdorin tubacionin e nat' ujit dhe të ujërave;
- Përkrahje i harkut-vetull mbi harkun e qendrës;
- Pastrim i shtresës së përmirës dhe shpatës anësore;
- Pastrim i vegetacionit dhe theksave përreth urës.

iktk.gov.al



**PROJEKTE RESTAURIMI**

Në kuadër të projektit “Restaurimi i urës në fshatin Haskovë”, do të kryhen ndërhyrjet si më poshtë:

- Pastrim, injektim, fugalim me lac gëlqerore i muraturës, plotësim me material gur ku ka mungesë;
- Restaurim konsolidim i krusit me lac gëlqerore;
- Restaurim muri gur me metodën shëp-qep;
- Restaurim i shtresës së kalidremit sipas modelit original;
- Pastrim i vegetacionit dhe patinës biologjike.

iktk.gov.al



**PROJEKTE RESTAURIMI**

Në kuadër të projektit “Restaurimi i murit mbajtës në fasadën perëndimore të Banesës Fico”, do të kryhen ndërhyrjet si më poshtë:

- Përfundim i pajantimit të objektit në 16 tre katet me elemente druri;
- Konsolidim i krusit të murit;
- Restaurim çatje me rraza druri;
- Shtesim muri gur të brendshëm me lac gëlqerore;
- Restaurim dysheme druri;
- Restaurim tavani druri.

iktk.gov.al



**PROJEKTE RESTAURIMI**

**Ura në përroin e Bënjës**, ndodhet në dalje të fshatit me të njëjtin emër. Objekti është pajant kulturor, Monument Kulture i kategorisë I-rë, dt. 06.01.1977. Në kuadër të projektit të restaurimit të urës, do të kryhen ndërhyrjet si më poshtë:

- Restaurim muri gur në lartësi;
- Restaurim i çarjeve me teknika e injektimit;
- F.V. mur betoni;
- Pastrim nga bimësia e ujit.

iktk.gov.al



**PROJEKTE RESTAURIMI**

Në afërsi të fshatit Glinë, ndodhet një urë me katër harkore. Njëzet të katër mura për në fshatin Glinë, ndërsa ura më e madhe është **Ura e Glinës**. Në kuadër të projektit të restaurimit të urës, do të kryhen ndërhyrjet si më poshtë:

- Restaurim dhe vendosja e gurëve të koroburës të urës;
- Vendosja e kalidremit me gurë gëlqeror;
- Realizim i shtresave dhe rrethorës së gurëve gëlqeror;
- Restaurim i çarjeve të muraturës me teknika e injektimit;
- Pastrim nga vegetacioni dhe patina biologjike;
- Vendosja e një paneli informues mbi monumentin.

iktk.gov.al